



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 8-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 21.11.2022, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 14,⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Skender Bikliqi, kryesues
2. Gentianë Hoxhaj, anëtare
4. Shahadije Bikliqi Dragaçina, anëtare
5. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
6. Enver Kryeziu, anëtar
7. Idajet Garip, anëtar
8. Zoran Cirkovic, anëtar

Të tjerë prezent

1. Naser Sinani, komandant i stacionit policor në Lipjan
2. Lulzim Qerimi, nënkryetar i komunës
3. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
4. Të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**,

Kryesuesi i Komitetit Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se ftesën me material e keni marrë me kohë dhe e lexoi në vazhdim:

REND DITE

1. Aprovimi i Ekstrakteve nga mbledhja 6 dhe 7 të Komitetit për Komunitete
2. Informatë nga përfaqësuesit e stacionit policor në Lipjan dhe nga Kryesuesi i KKS-së lidhur me gjendjen e sugurisë në Komunën e Lipjanit
3. Të ndryshme

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimisht me 8 vota aprovoi këtë:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i Ekstraktit nga mbledhja 6 dhe 7-të e Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime të ekstraktit nga mbledhja 7 -të e Komitetit për Komunitete?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht votoi.

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës.

II

Informatë nga përfaqësuesit e stacionit policor në Lipjan dhe nga Kryesuesi i KKSB-së lidhur me gjendjen e sugurisë në Komunën e Lipjanit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, ia kaloi fjalën Naser Sinanit, komandant në stacionin policor në Lipjan, i cili në pika të shkurta i njoftoi rreth kësaj pike.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Zoran Cirkovic, tha se e falënderoj komandantin për informatë, ne si komitet kemi pas bashkëpunim shumë të mirë me stacionin policor dhe do herë kanë qenë bashkëpunues me neve. Stacioni policor po bënë punë të shkëlqyer dhe është shembull për të mirë dhe do të ishte mire që edhe institucionet tjera të jenë kështu.

Sllavisha Trajkovic, i bashkëngjitëm parafolesit për punën e mirë që po e bëjnë, policia e Lipjanit dhe e Kosovës. Por e kam një vërejtje të vogël para një kohe disa fëmijë janë gjuajtur me vezë dhe janë njoftuar policia por nuk kanë intervenuar.

Naser Sinani, tha ju falënderoj edhe juve për bashkëpunimin dhe fjalët e mira që po i flisni ndërsa rastin për të cilin po flisni në atë kohë kemi pas raste me të rënda dhe u dashtë me u marr me ato që janë me më prioritet.

Zoran Cirkovic, rasti në fjalë nuk ka qenë i qëllimshëm dhe ka qenë rast që ka të bëjë me disa fëmijë për festat e hallovinit.

Shahadije Bikliqi, tha se cilat komitete po kanë me shumë probleme.

Naser Sinani, me shume ka probleme të komuniteti shqiptarë pasi që janë numër me i madh.

Lulmturije Bytyqi-Hasani, tha se e falënderoj komandantin për informatën, dhe tha se shqetësuese janë përdoruesit e narkotikëve, ju si stacion çfarë masa keni ndërmarr.

Naser Sinai, tha se ne çdo dite jemi ne teren dhe kemi ekipet e ndara për këtë çështje po ashtu kemi edhe ekipet për ligjërata ne shkolla dhe jemi duke punuar vazhdimisht.

Sllavisha Trajkovic, tha se kam një kërkesë që tani pasi që te rruga ka kisha përballë furrës po ndalen shumë veturat dhe aty po bëhen kolona , ka qenë mirë me ndërmarr masa.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se po e njëjta gjendje po është edhe te rruga e ambulancës ku veturat po e bllokojnë rrugën shpesh herë, për shkak që po ndalin veturat ne rrugë dhe vozitësit po hyjnë në barnatore.

Naser Sinai, tha e dije për te dy rastet por nganjëherë edhe ne jemi ne pozite te vështire se dikush mundet me pas ndonjë familjar te sëmur dhe ne edhe me shqiptuar gjobe nuk është edhe aq e lehtë.

Skender Bikliqi, tha se e falënderojmë komandantin për informatën por edhe për bashkëpunimin që po kemi.

Pastaj u kalua në pikën të ndryshme.

III

Të ndryshme

Lumturije Bytyq-Hasani, tha se ne si komitet ne mbledhjen e kaluar kemi qen ne teren ne Janjevë siç jeni ne dijeni edhe ju edhe kemi dal me disa rekomandime të cilat do ti lexoj kolegëja Shehadija

Shahadije Dragaqina, tha se Rekomandimet për procedim te ekzekutivit komunal të projekteve të investimeve kapitale për Janjevë janë:

1. Riparimi i gypave në rrjetin e kanalizimit në lagjen e komunitetit rom
2. Investime në rrjetin e ujësjellësit në tërë fshatin
3. Asfaltimi i rrugës "Shtjefan Gjeqovi" dhe rrugës që lidhë Janjeven me Teqen
4. Riparimi i rrugës "Saraj" e cila është e dëmtuar nga punimet rreth instalimit të ujësjellësit.
5. Investimet në rifunksionalizimin e Qendrës së Kulturës/Kinemasë e cila tashme po përdoret si shtëpi banimi.
6. Riparimi/pastrimi i shtratit të Lumit të fshatit.

Pastaj kryesuesi i komitetit tha se po e hodhi ne votim këto rekomandime, pastaj u konstatua se komiteti me te gjitha votat prezent votoi këto rekomandime.

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15⁴⁵.

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit
Skender Bikliqi